Viti 1913 - SIR ROBERT GRAVES



Mal Berisha

NJË MISION OTOMAN NË TOKËN E PAZOT TË TURQISË EUROPIANE

Sir Robert Windham Graves (1858-1934) ka qenë një diplomat britanik i lindur në Irlandë. Ai e filloi karrierën si përkthyes në Stamboll në vitin 1879. Hyri në shërbimin konsullor britanik, duke shërbyer në Perandorinë Osmane. Në vitin 1912 u bë këshilltar financiar i qeverisë turke dhe me atë cilësi në muajin e fundit të qeverisjes osmane shërbeu në Shqipëri. Ai shkroi librin “Qendrat e furtunës së Lindjes së Afërt”, botuar në Londër në vitin1933.

Graves-i e ka kaluar në këmbë tërë Kosovën, Prizrenin, Gjakovën dhe qytete të tjera dhe na ka dhënë një pamje shumë interesante të periudhës përfundimtare të sundimit osman në Shqipëri. Në përshkrimet e tij vihen në pah vlerat dhe virtytet shqiptare, por për fat të keq edhe prapambetja e jashtëzakonshme, madje aq prapambetje sa nganjëherë ai e konsideron Shqipërinë si një vend me “orë të ngecur” prej shumë shekujsh.

Proud to be Albanian